



01.Nr 174/10
Më: 29.07.2010

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VII-të (VI-të për v. 2010) jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal në Vushtrri mbajtur më 09.6. 2010

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën **10:05**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri, përveç Refik Ramaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë.

Zeqir Hasani- paraqiti vërejtje lidhur me dërgimin e materialit të seancës në fjalë për anëtarët e Kuvendit vetëm një ditë para seancës. Në vazhdim paraqiti këto vërejtje: pasqyrat buxhetore janë të pakomentuara dhe kanë mospërputhje. Poashtu në rishikim duhet të futet i tërë buxheti, e jo vetëm investimet kapitale. Pastaj mosefikasiteti dhe moskoordinimi i drejtorëve në hartimin e projekteve dhe mosdorëzimi i tyre me kohë në Qeveri, ka sjellur humbjen e granteve të shumta për Komunën e Vushtrrisë, dhe si pasojë ka ardhur mosrealizimi i projekteve të shumta, dhe si shembull përmendi anashkalimin e mirëmbajtjes së institucioneve shkollore.

Veli Karaça- tha se seanca që është thirrur urgjentisht është e papërgatitur dhe nuk ka arsye për një kohë kaq të shkurtër të vendoset për një akt kaq të rëndësishëm për Komunën e Vushtrrisë, dhe shtoi se materiali është shpërndarë dje, por mungon edhe arsyetimi pse kjo seancë është kaq urgjente.

Sabit Kadriu- tha se nëse kërkohet që gjithsesi të aprovohet ky buxhet për shkak të vonesave që mund t'i ketë, duhet gjithsesi ta votojmë, por nëse ka kohë, është mirë të na japin kohë dhe të studiohet më mirë.

Muharrem Shabani- tha se edhe pse seanca e jashtëzakonshme është thirrur me kërkesë të Kryetarit të Komunës, mungon kërkesa dhe nuk e kemi parë fare, prandaj kërkoi arsyet pse në këtë mënyrë të jashtëzakonshme është ftuar seanca në fjalë, pasi që alineja 4 parasheh afatin 3 ditor.

Isuf Jashari- njoftoi se të mërkurën pasdite ka marrë shkresën nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe për të premtën ka qenë afati për ta dorëzuar rishikimin e buxhetit, por ka bërë një shkresë prapë dhe ua ka bërë të ditur që është e pamundur që të thirret Kuvendi për dy ditë për ta kryer rishikimin e buxhetit dhe e

ka shtyer afatin deri të mërkurën dhe kjo kohë ka qenë e nevojshme për konsultime të materialit. Në vazhdim shpjegoi qëllimin e rishikimit të buxhetit.

Ferit Idrizi- tha se nuk ia vlen që të shtyhet seanca në fjalë, duke kërkuar që seanca e jashtëzakonshme të mbahet sot dhe të votohet rendi i ditës.

Sabit Kadriu- pyeti se a ka sanksione nëse shtyhet kjo seancë? A i kanë përfshirë të gjitha kërkesat e qytetarëve ? A ka mundësi të bëhet lëvizje e prioriteteve, nëse e aprovojmë sot buxhetin?

Isuf Jashari- u përgjigj se nëse nuk aprovohet sot, disa programe buxhetore do të mbesin minus në paga dhe nuk do të mund të bëhet realizimi i pagave. Ndërsa lidhur me pyetjen se a janë përfshirë të gjitha kërkesat, tha se janë përfshirë të gjitha prioritetet që janë aprovuar në Kuvendin e Komunës me vendimin e anëtarëve të Kuvendit, por edhe ndryshimet mund t'i bën Kuvendi i Komunës për ndryshim në çdo program, qoftë nga kategoria e investimeve kapitale apo nga programet tjera buxhetore.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 26 vota “për”, 6 “kundër”, të tjerët “abstenim” , aprovoi këtë:

REND DITE

1. Rishikimi i buxhetit të Komunës për vitin 2010.

Qazim Azemi- tha se nuk është kjo mënyrë e mirë e diskutimit për një çështje me rëndësi të madhe për Komunën tonë. Pastaj në këtë rishikim mungojnë disa projekte dhe propozime kapitale të Komunës sonë, e që janë të kahmotshme, dhe si problem e përmendi mungesën e ujit të pijshëm, pra është hequr fabrika e ujit, dhe janë hequr edhe projekte tjera kapitale, siç është kolektori kryesor, janë hequr 3-4 shkolla, është hequr mirëvajtja në shkolla për vitin 2010. Në vazhdim tha se mungon renovimi për dyer dhe dritare në shkollën “Lutfi Musiqi”, mandej tha se figuron projekti i renovimit për shkollën “Latif Berisha”, kur dihet që shkolla ka përfunduar renovimin.

Isuf Jashari- paraqiti sqarimet hyrëse.

Muharrem Shabani- pyeti se kush i ka dhënë këto propozime për ndryshim?

Isuf Jashari- u përgjigj se për shkak të procedurës emergjente kanë realizuar takim me Kryetarin dhe me këshilltarët e tij dhe kanë marrë vendim bashkarisht duke përgatitur shkresën që ua kanë dërguar të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Pajazit Pllana- lidhur me pikën 18, tha se pasi që komunitetit serb iu ka mundësuar kthimi dhe ndërtimi i shtëpive në fshatin Dolak dhe Shtitaricë, është dashtë të kryhen obligimet për dy trafo, një në Shtitaricë dhe një në Dolak, uji në Dolak, si dhe rrethimi i shkollës bashkë me fushë sportive. Në vazhdim tha se për trafon e Shtitaricës kanë participuar, dhe pyeti se ku ka mbetur procesi dhe pse nuk është kryer deri tash?

Bahrije Pllana- pyeti pse nuk është fusha e sportit në shkollën e Shtitaricës, pasi që janë ndarë mjetet për të.

Veli Karaça- tha se edhe përkundër argumenteve që u paraqiten, nuk ishin bindëse që kjo seancë të thirret kaq urgjent. Në vazhdim tha se ky është akti më i rëndësishëm që e aprovon ky Kuvend, prandaj është përgjegjësi shumë e madhe, dhe është e nevojshme që të konsultohen grupet asambleiste, forumet, shoqërinë civile, mjetet e të cilëve po i destinojmë për diçka. Kurse sa i përket materialit, tha se ka vërejtje duke filluar nga faja e parë, pasi që Kryetari e dërgon këtë shkresë përmes drejtorit, e që duhet të jetë e kundërta, nga drejtori përmes Kryetarit. Pastaj tha se nëse duhet aprovuar buxhetin në këtë formë siç është paraqitur, pse duhet

diskutuar nga anëtarët e Kuvendit për këtë rishikim të buxhetit. Sa i përket tabelave dhe materialit, tha se në faqe 2 dhe 3 janë tabela të palexueshme, dhe secilës tabelë i mungon arsyetimi ose një koment. Mandej ridestinimi i mjeteve ose ndërrimi i prioriteteve varet prej asaj që disa projekte i kemi planifikuar dhe presim që të realizohen nga grantet qeveritare, duke pyetur se a ka konfirmim që ata do t'i financojnë, sepse nëse ata nuk i financojnë, na duhet t'i japim prioritet me mjete vetanake sepse çdo detyrë ose është prioritare, ose është e rëndësishme, ose është urgjente. Kurse sa i përket projekteve që janë, tha se është dashtë që të ndahen një pjesë e mjeteve buxhetore për subvencionim të bujqësisë ose për dëmshpërblim të dëmeve nga vërshimet për bujqit. Pastaj një pjesë e mjeteve kishte me qenë mirë të destinohet për të rinjët dhe sportin. Poashtu gjendja e kategorive sociale po rëndohet gjithnjë e më shumë. Mandej të bëhen zvogëlime të shpenzimeve të panevojshme dhe raportin në mes të shpenzimeve për mallra dhe shërbime dhe investimeve kapitale. Gjithashtu tha se disa projekte që janë propozuar, janë nga bashkësitë lokale prej nga vjen edhe udhëheqja komunale ose janë të caktuara në bazë të kriterëve politike, pasi që në disa fshatra asfaltohen edhe rrugët brenda fshatit, ndërsa disa bashkësi lokale dhe fshatra ende nuk vijnë në rend, dhe propozoi që në projekte prioritare të hyjnë këto rrugë: rruga Dolak-Bukosh, rruga kah varrezat që shkon në Nedakoc, rruga nga Kosova Petrol për në Dobërllukë. Mandej tha se në tabelën faqe 9 është hequr rregullimi i rrugës me infrastrukturë “Dëshmorët e Kombit” dhe “Skënderbeu”, duke shtuar se 2.600 metra gyp janë nga azbesti që është një materie kancerogjene dhe shumë e rrezikshme për shëndetin e qytetarëve, prandaj kërkoi që kjo të jetë projekt prioritar. Poashtu ka pasë mundësi që disa grante të zvogëlohen, siç është gjelbërimi dhe rregullimi i parqeve dhe mirëmbajtja e varrezave. Lidhur me rregullimin e sistemit me ujë të pijshëm, tha se kompania rajonale e ujësjellësit është kompani e cila është përgjegjëse për zgjerim të rrjetit. Ndërsa lidhur me projektet tjera, tha se renovimi i kulmit të Palestrës Sportive është më me prioritet se sa muri i rrethojës së Shtëpisë së Kulturës. Në fund tha se ka edhe projekte tjera që nuk janë prioritare.

Sabit Kadriu- tha se materiali për seancën e jashtëzakonshme ka ardhur me nguti. Poashtu tha se shkrimet në material janë paraqitur me shkronja shumë të vogla. Pastaj tha se ka fshatra që kanë shpenzuar mjete për të hartuar projekte për rrugët e tyre, dhe nuk figurojnë këtu në rishikim të buxhetit. Mandej kërkoi që të futet si prioritet ndërtimi i urës që lidhet me fshatin Prelluzhë. Gjithashtu pyeti pse duhet investuar në renovimin e gjimnazit, nëse mendohet që gjimnazi do të kalon në një objekt tjetër?

Besim Jashari- paraqiti vërejtje për formën e gabuar të adresimit të shkresës për seancën e jashtëzakonshme, poashtu vërejtje paraqiti edhe për mungesën e Kryetarit të Komunës në seancën në fjalë. Pastaj duke iu referuar shkresës së Ministrisë së Financave, tha se nuk ka qenë e nevojshme ta kenë anëtarët e Kuvendit këtë shkresë, pasi që ministri iu ka drejtuar Kryetarit të Komunës.

Muharrem Shabani- në një seancë të Kuvendit ku që nga fillimi ka shkelje të procedurave ligjore, një çështje që është serioze siç është buxheti, konsideroj se është vështirë të merret pjesë pasi që shihet se është vetëm një formalizëm, dhe Kuvendi është shndërruar në një makinë të ngritjes së duarve dhe me vota të votohet, e jo të bisedohet, prandaj nevojitet një transparencë shumë më e madhe dhe respektim të të gjitha procedurave ligjore, duke shtuar se procedimi që nga fillimi ka shkelje ligjore. Pastaj tha se edhe më herët forma e miratimit të buxhetit dhe lista e projekteve kanë qenë në mënyrën formale dhe jo përmbajtësore, është miratuar një buxhet i paqëndrueshëm, jo i balancuar, jotransparent sikur qysh po bëhet edhe tani. Në vazhdim tha se qytetarët e Vushtrrisë duhet ta kenë të qartë se projektet të cilat atyre iu janë premtuar, më nuk ekzistojnë, sikur që nuk ekziston në vitin 2010 çështja e kolektorit kryesor, ndërtimi i fabrikës së ujit, kolektori për ujëra të zeza, kolektori tjetër, ndërtimi i shkollës në Pestovë, Bukosh, Karaçë, rruga

Vushtrri-Druar-Gllavotin, rruga Nedakoc, Samadrexhë, duke shtuar që tash është propozuar blerja e veturës, që është e tepërt. Pastaj pyeti se si mund të parashikohet një rrugë prej tri metrave në lagjen "Mustafa" në Smrekonicë, dhe ajo rrugë është kryer, por përsëri po kërkohen mjete. Gjithashtu është hequr një projekt kapital, çështja e rregullimit të rrugës "Dëshmorët e Kombit". Pastaj kërkoi që të hiqet blerja e veturës, pasi që veturat aktuale janë shumë të mira. Mandej nuk kemi informacione se çfarë kemi nga donacionet e jashtme. Në fund tha se ky Kuvend së bashku me Kryetarin duhet t'iu kërkojnë falje qytetarëve të Komunës për të gjitha ato që ka premtuar me buxhetin paraprak dhe që nuk po i realizon.

Samir Istrefi- tha se grupi asambleistë i PDK-së mbështet dhe voton rishikimin e buxhetit për shkak se nëse ndonjë Kryetar i Komunës dhe qeveri komunale duhet të mburret për rishikime, shpenzime dhe planifikime, atëherë është kjo qeveri komunale. Në vazhdim lidhur me mungesën e Kryetarit të Komunës në seancë, tha se Kryetari gjendet në një takim të rëndësishëm me Presidentin e Kosovës. Pastaj vlerësimin e veturave e bëjnë vetëm kompanitë e licencuara për këtë çështje, e jo të vlerësohen nga anëtarët e Kuvendit. Mandej tha se u paraqiten shumë vërejtje, por munguan propozimet konkrete se cilat projekte mendojnë që janë më të drejta, më të favorshme për qytetarët, se sa këto propozime që kanë ardhur nga Kryetari dhe qeveria e tij komunale, duke shtuar se Kryetari aktual duhet të mburret për modestinë në raport me qytetarin dhe shërbimet, dhe paranë e qytetarit, pasi që treguesi më i mirë janë shpenzimet në zyrën e tij dhe llojin e komoditetit që ka në raport me të tjerët çfarë e kanë pasë. Në fund arsyetoi prioritetet e propozuara me rishikimin e buxhetit.

Isuf Jashari- tha se për shkak të procedurës dhe afatit të shkurtër kohor, na si drejtori në bashkëpunim me Kryetarin dhe drejtorët e drejtorive kemi qenë të obliguar ta punojmë rishikimin dhe në afat të duhur kohor ta dorëzojmë me vërejtje dhe sugjerime të anëtarëve të Kuvendit. Në vazhdim lidhur me Q.Azemin i cili tha se mungojnë disa projekte kapitale, u përgjigj se projektet që janë me donacione nuk hyjnë në projektet kapitale që i dorëzojmë me grant qeveritar të Komunës dhe të të hyrave vetanake, dhe me rishikim të buxhetit asnjë nga këto projekte nuk hyjnë në rishikim të buxhetit. Sa i përket mirëmbajtjes së shkollave, tha se është një pjesë e buxhetit e planifikuar tek mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtje të shkollave. Pastaj tha se faqe nr. 7 janë të gjitha projektet që janë hequr dhe ato që janë shtuar, dhe shtoi se të gjitha projektet mbesin në rishikim si listë e projekteve. Në arsim ka pasë një ndryshim, pasi që ka pasë një donacion, dhe shuma e një pjese të donacionit është ndarë për renovime të ndryshme të shkollave.

Qazim Azemi- faqe 6, te plani i ndarjeve, tha se tek arsimit parafillor askund nuk figurojnë të hyrat vetanake.

Isuf Jashari- u përgjigj se këto janë shuma të ndryshmeve, kurse janë në një tabelë tjetër, por nuk figurojnë aty, pasi që kjo është forma standarde që e punojmë.

Qamil Sahiti- tha se me planifikim janë ndarë më herët 15.000 € për renovimin e kulmit të Palestrës, por pas një testi (provë) që është bërë në Palestër me disa ndryshime dhe me një shpenzim jashtëzakonisht të vogël ka pasë sukses në njërën pjesë, kurse sot zotohen mjetet tjera për ndaljen e pikës së kulmit të Palestrës Sportive.

Xhevahire Izmaku- njoftoi që Kryetari i Komunës gjendet në një takim me Presidentin e Kosovës dhe nuk ka pasë qëllim që t'i ik seancës së jashtëzakonshme, por në seancë është këshilltari i Kryetarit, i cili edhe e ka fjalën kryesore për çështjen në fjalë. Të gjitha propozimet që kanë ardh, nuk janë propozime të ardhura nga rruga, as propozime të drektuara nga politika, por janë propozime që vijnë edhe nga grupet e qytetarëve të cilët kanë takime të rregullta me Kryetarin e Komunës çdo të premtë, kurse pjesët tjera vijnë nga qeverisa. Në vazhdim njoftoi se fabrika e ujit është në tender dhe deri në fund të muajit do të kuptohet se kush është fituesi i tenderit, dhe shtoi se fabrika do të ndërtohet nga buxheti i Kosovës, dhe janë

të ndara mjetet. Pastaj tha se vetura e Kryetarit është e prishur dhe ka nevojë për një veturë tjetër.

Qazim Azemi- në emër të grupit asambleistë të AAK-së tha se duke e parë që ky rishikim i buxhetit të Komunës i propozuar për sot ka qenë i ngutshëm, nuk është serioz dhe në të nuk janë përfillë ato që vet ky Kuvend më herët i ka aprovuar, dhe bëri të ditur që nuk do ta votojnë, pasi që nuk janë fut prioritetet dhe nuk janë fut kërkesat e qytetarëve. Në vazhdim paraqiti vërejtje që është hequr ndërtimi i shkollës në fshatin Karaçë, pasi që aty është një shkollë barakë.

Isuf Jashari- duke iu përgjigjur pyetjes së P. Pllanës, tha se mjetet ende janë të lira për shkak se komuniteti me përfaqësuesit e tij akoma nuk kanë ardh me një shkresë konkrete.

Besim Jashari- kërkoi që urgjentisht të mbyllen gropat në rrugën “Dëshmorët e Kombit”. Pastaj e përkrahu propozimin për ndërtimin e urës që lidhet me fshatin Prelluzhë, dhe kërkoi që t’i ipet prioritet urës në Pestovë.

Veli Karaça- tha se ky projekt-buxhet nuk është përgatit mirë, ka hapësirë të rishikohen prioritetet edhe një herë, pasi që është çështje shumë e ndjeshme, prandaj grupi asambleistë i LDK-së nuk e mbështet këtë projektpropozim të buxhetit.

Xhevahire Izmaku- lidhur me dy urat, tha se gjatë takimit me KFOR-in kanë kërkuar mbështetje për urën e Pestovës dhe javën e ardhshme do të bëhet rregullimi i urës. Kurse çështja e urës në Prelluzhë nuk është problem teknik apo buxhetor, por është problem politik, por bëri të ditur se janë duke bërë përpjekje në vazhdimësi për fillimin e ndërtimit të urës në Prelluzhë.

**Në vazhdim pas votimit me 19 vota “për” , 13 “kundër” , të tjerët “abstenim”
u vendos:**

Aprovohet rishikimi i buxhetit për vitin 2010.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

**Procesmbajtësi:
Albanez Tahiraj**

**Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi**